

## KONTRATE DHURIMI KUOTASH

Sot me date 03.07.2024 (dymijeenjezetekater) u hartua kjo KONTRATE DHURIMI KUOTASH te Shoqerise "E.A.E. 2004" Sh.p.k me palet si me poshte:

### DHURUES

Zj. **Adelina Raska**, lindur në Diber dhe Banuese në Tiranë Rruga "Korabi", Banese Private nr. 99 Hyrja 1, identifikuar Leternjoftim ID nr. I45404100O, Ortak i Vetem i Shoqerise "E.A.E. 2004" Sh.p.k, zoterues i 100% te kuotave te kapitalit, qe korespondojne me 100% te kapitalit te shoqerise, baras me 100.000 leke, te gjithë kapitali qe zoteron me Shoqeri, t'ja dhuroje Z. Arlind Raska,

### PRANUESI I DHURIMIT

Z. **Arlind Raska**, i datelindjes 11.12.2004, lindur dhe banues në Tiranë Rruga "Korabi", Banese Private nr. 99 Hyrja 1, me ID **K41211062U**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

### BAZA LIGJORE

Referuar Ligjeve ne Republiken e Shqiperise:

- Nr.9901 dat e 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare"
- Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit"
- Akt Themelimin dhe Statuti i shoqerise "E.A.E. 2004" shpk NUIS M41604019U

Kjo Kontrate Dhurimi Kuotash perpilohet mbi bazen e Vendimit date 03.07.2024 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "E.A.E. 2004" sh.p.k, regjistruar ne QKB e pajisur me NUIS M41604019U me Seli Rruga "Korabi", Banese Private nr. 99 Hyrja 1, Paskuqan, Tiranë.

### OBJEKTI

Mbi bazen e Vendimit Date 03.07.2024 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "E.A.E. 2004" Shpk, me NUIS M41604019U, ne pranine e paleve respektive perpilojme kete KONTRATE DHURIMI KUOTASH me objekt: Zj. Adelina Raska, ortak i vetem i Shoqerise "E.A.E. 2004" Shpk, zoterues i 100 % te kuotave te kapitalit vendos qe te gjithë kapitalin qe zoteron ne shoqeri, t'ja dhuroje Z. Arlind Raska.

- Pas kryerjes se keitj AKTI DHURIMI, e pasqyrimit te ketyre veprimeve prane QKB Tirane, pjesmarrja ne kapitalin e Shoqerise "E.A.E. 2004" Shpk peson keto ndryshime:
- Zj. Adelina Raska, Ortak Themelues i Shoqerise "E.A.E. 2004" sh.p.k, zoterues i 100 % te kapitalit te Shoqerise, Zhvishet nga i gjithë kapitali qe zoteron ne pjesmarrjen e tij ne shoqeri.
- Z. Arlind Raska, behet zoterues i 100% te kuotave qe korespondojne me 100 % te kapitalit te Shoqerise "E.A.E. 2004" Shpk, dhe emerohet **Administrator** nga data 03.07.2024.



A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke at the end.

Kjo KONTRATE DHURIMI KUOTASH e Shoqerise "E.A.E. 2004" Shpk u perpilua ne dy faqe, ne kater kopje me vlere te njejte ligjore, u lexua nga palet e interesuara, kuptohet prej tyre, pasi u gjet e perpiluar ne perputhje me vullnetin e tyre te lire e te plote dhe me Ligjin, u nenshkrua rregullisht.

DHURUES  
"E.A.E. 2004" Shpk

Ortak i vetem

**Adelina Raska**

*Adelina Raska*



PRANUES I DHURIMIT

**Arlind Raska**

*Arlind Raska*

